



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 7 prill 2014**

**Numri i lëndës: 2013-24**

**Emin Maxhuni**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 prill 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 24 tetor 2013.

## **II. FAKTET**

2. Më 5 shkurt 2008, ankuesi ka parashtruar në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) një kërkesë për pronë kundër N.V. dhe S.L., në lidhje me dy banesa në një ndërtesë në Prishtinë.
3. Më 26 tetor 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) ka vendosur që ankuesi kishte vërtetuar pronësinë e tij mbi pronën në fjalë dhe kishte të drejtë mbi pronësinë e tij. KKPK-ja ka urdhëruar të paditurit: N.V. dhe S.L. që t'i lirojnë banesat brenda 30 ditëve.
4. Të paditurit kanë paraqitur ankesë kundër këtij vendimi më 26 janar 2012.
5. Më 30 tetor 2012, Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, me një kolegji të përbërë nga gjykatës të Kosovës dhe ndërkombëtarë, ka miratuar ankesën dhe ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 5 shkurt 2008. Gjykata ka konstatuar se ankuesi nuk kishte arritur që të dëshmonte të drejtat e tij pronësore mbi banesat në fjalë.
6. Kopje e vendimit i është dërguar ankuesit më 9 shtator 2013.

## **LIGJI NË FUQI**

**Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale**

ndryshuar nga

**Ligji Nr. 03/L-079 që ndryshon Rregulloren 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale**

### **Kapitulli II Agjencia Kosovare e Pronës Neni 3**

#### **Përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Pronës**

3.1 Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive ka kompetenca për të pranuar dhe për të regjistruar, dhe përmes Komisionit për kërkesa pronësore ka kompetenca për t'i zgjidhur, kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:

- (a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe

- (b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.

### **Kapitulli III Organizimi i Agjencisë Kosovare të Pronës**

#### **Neni 4 Organizimi i Agjencisë Kosovare të Pronës**

Agjencia Kosovare e Pronës përbëhet nga Këshilli Mbikëqyrës, nga Sekretaria ekzekutive dhe nga Komisioni për Kërkesa Pronësore (Komisioni).

#### **Neni 7 Komisioni për kërkesa pronësore**

7.1 Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë. Ata emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Deri në përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, dy nga tre anëtarët e Komisionit, duke përfshirë kryesuesin, do të emërohen nga përfaqësuesi civil ndërkombëtar.

...

### **Kapitulli IV E drejta në ankesë**

#### **Neni 12 Ankesat**

12.1 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

...

12.8 Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjykatësve të emëruar nga kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës. Deri në përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, dy nga tre gjykatës do të jenë përfaqësues ndërkombëtarë, të emëruar nga përfaqësuesi civil ndërkombëtar.

...

#### **Vendimi mbi ankesën**

13.1 Gjykata Supreme e Kosovës sipas rregullit vendos mbi ankesën bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjykatë dhe të shqyrtuara nga Komisioni.

13.2 Kur është e arsyeshme, në bazë të dëshmive të paraqitura si duhet, Gjykata Supreme vetë mund të vendosë mbi faktet e vlerësuara nga Komisioni.

13.3 Gjykata Supreme:

- (a) e pranon ankesën dhe merr vendim të ri me ndryshimet që mund të kërkohen në vendimin e Komisionit;
- (c) e refuzon ankesën si të papranueshme për arsye procedurale; ose
- (d) e refuzon ankesën si të pabazuar dhe e vërteton vendimin e Komisionit.

### III. ANKESAT

7. Ankuesi pohon se e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është shkelur dhe aktgjykimi i gjykatës së apelit ishte i pabazë, arbitrar dhe i padrejtë. Ai gjithashtu pohon se janë shkelur të drejtat e tij për mbrojtjen e pronës dhe të barazisë para ligjit.

### IV. LIGJI

8. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
9. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
10. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e gjyqësisë, policisë dhe doganës.
11. Paneli konstaton se ankesa i drejtohet vetëm vendimit të gjykatës së apelit, e jo KKPK-së. Prandaj, Paneli nuk ka nevojë që të vendos se a është kompetent për të vlerësuar ankesat ndaj vendimeve të KKPK-së.
12. Paneli ka konstatuar në shumë raste se sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së vet të punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund t'i shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk nënkupton se ja humb atyre gjykatave karakterin e tyre e të qenuarit pjesë e gjyqësorit të Kosovës (shih, *ndër të tjera, Halili kundër EULEX-it*, 2012-08, 15 janar 2013, paragrafi 21; *Pajaziti kundër EULEX-it*, 2012-05, 4 tetor 2012, paragrafët 9-10; *Dobruna kundër EULEX-it*, 2012-03, 4 tetor 2012; paragrafi 12).
13. Prandaj, këto ankesa nuk hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit, ashtu siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit sipas nenit 29 (d) të rregullores së punës, dhe

**SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese